



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA III

Sesioni Pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 53
Prishtinë, më 14.07.2010 në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N 10

P R O C E S V E R B A L

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë : Arsim Rexhepi, kryetar, Drita Kadriu, Enis Kervan, Donika Kadaj –Bujupi, Heset Cakolli, Ismajl Kurteshi.

Munguan : Adem Hajdaraj, Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq.

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj - Ministër MASHT, Mujë Rugova – Rektor UP, Ferdiqe Zhushi-Etemi dhe Basri Muja – Agjencia e Akreditimit, Avdulla Alija – Drejtor i Departamentit të arsimit të lartë MASHT.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë : Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e udhëhoqi: Arsim Rexhepi kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportimi i përfaqësuesve të MASHT, AAK dhe Rektorit të UP-së lidhur me procesin e akreditimit të Fakultetit të Edukimit në Prizren dhe Gjiçan;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Raportimi i përfaqësuesve të MASHT, AAK dhe Rektorit të UP-së lidhur me procesin e akreditimit të Fakultetit të Edukimit në Prizren dhe Gjilan

Ministri i Arsimit Enver Hoxhaj - prezantoi para Komisionit raportin e Këshillit Kombëtar të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit si për institucionet e arsimit të lartë publike dhe ato private. Me këtë rast ai tha se qëllimi i Ministrisë është që të sigurohet cilësi në institucionet e arsimit të lartë. Lidhur me Universitetin e Prizrenit, Ministri tha se programet e këtij Universiteti kanë aplikuar për akreditim dhe Agjencioni Kosovar për Akreditim ka rekomanduar që ky Universitet të shpall konkurs për pranim të studentëve për këtë vit akademik ndërkohë që të vazhdojë me procesin e akreditimit i cili do të përfundojë me fillimin e vitit akademik. Ministri i njoftoi anëtarët e komisionit se gjatë muajit shtator i gjithë materiali lidhur me themelimin e Universitetit të Prizrenit do të dërgohet në Kuvend ku edhe do të merret vendimi mbi themelimin e tij. Po ashtu ai tha se në vendimin e Qeverisë parashihet që Fakulteti i Edukimit të jetë pjesë e Universitetit të Prizrenit.

Enis Kervan - pajtohet me vendimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit, ndërsa paraqiti shqetësimin për mos pranimin e studentëve të rinj në Master në programin e Gjyhës dhe letërsisë Turke këtë vit akademik në Universitetin e Prishtinës.

Drita Kadriu - tha se i përkrah rekomandimet e Agjencisë Kosovare të Akreditimit të cilat janë në interes të ngritjes së cilësisë së arsimit.

Donika Kadaj – Bujupi – tha se çdo hap i marr që ndërlidhet me ngritjen e cilësisë së arsimit dhe përmirësimit të saj duhet të përkrahet. Po ashtu ajo kërkoj nga Ministri që të jenë të informuar në vazhdimësi lidhur me themelimin e universiteteve tjera në qytetet tjera të Kosovës.

Heset Cakolli – konsideron se rekomandimet e Agjencionit Kosovar të Akreditimit janë të drejta. Ai kërkoj sqarim nga Ministri lidhur me transferimin e Fakultetit të Edukimit nga Gjilani e Prizreni në Prishtinë.

Ismail Kurteshi – tha se mos akreditimi i disa programeve arsyetohet për shkak të mungesës së kuadrit mësimor, në këtë rast kërkon sqarim se mbyllja e programeve a do të thotë reduktim i studentëve apo do të ketë përqendrim në një Universitet në këtë rast a do të dëmtohet cilësia e arsimit. Me tej shtoi se a ndikon tregu i punës në reduktimin apo mbylljen e këtyre programeve.

Ferdije Zhushi - Etemi - tha se procedurat për Akreditimin e bartësve publik dhe privat janë realizuar sipas standardeve dhe udhëzimeve evropiane në përputhje me dokumentet e Agjencisë Kosovare për Akreditim. Në këtë proces kanë marrë pjesë shumë ekspert nga vendet e ndryshme si Austria, Finlanda, Danimarka etj. Ajo i njoftoi anëtarët e Komisionit se vendimet e Agjencisë Kosovare të Akreditimit janë ta pa negociueshme. Po ashtu ajo theksoj se rekomandimet e nxjerra janë bërë pas një pune dhe analize të gjatë të çështjeve një nga një në këto programe dhe se Agjencioni ka shprehur shqetësimet lidhur me Fakultetin e Edukimit.

Drita Kadriu - kërkoj sqarim nga përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Akreditimit lidhur me procesin e akreditimit për institucionet e arsimit të lartë në Mitrovicë.

Ferdije Zhushi – Etemi - theksoj para anëtarëve të Komisionit se është akredituar Fakulteti i Shkencave Aplikative ndërsa deri në shtator të këtij viti do të kemi një raport nga Agjencioni lidhur me procesin e akreditimit për fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë.

Rektori Mujë Rugova – para Komisionit tha se nga dita e nesërme do të mbahet mbledhja e senatit në të cilin do të prezantohet numri i studentëve që parashihet të pranohen në vitin akademik 2010/2011. Po ashtu i njoftoj anëtarët e Komisionit se pas marrjes së raportit të Agjencionit Kosovar të Akreditimit pritet shpallja e konkursit për pranimin e studentëve.

Rektori me tej shtoj se është bërë kërkesë në Agjencionin e Akreditimit që në këtë vit akademik 2010/2011 në Gjilan të fillojë me dy programe tjera në shkencat juridike dhe programin e shkencave ekonomike pasi që ka hapësirë të mjaftueshme. Në degën e Fakultetit të Edukimit në Gjakovë përveç dy programeve, të arsimit parashkollor dhe programit të arsimit fillor planifikohet që këtë vit akademik të shtohen edhe dy programe. Në Pejë planifikojmë që përveç programit të Fakultetit të Biznesit në këtë vit akademik të vazhdojmë edhe me programin e shkencave juridike.

Lidhur me komunitetet Rektori theksoj se vitin e kaluar të gjithë kandidatet që kanë aplikuar nga radhët e komunitetit Turk e Boshnjak janë pranuar edhe pse nuk e kanë kaluar pragun e paraparë për pranim në Universitet.

Ismail Kurteshi - kërkoj sqarim nga rektori lidhur me ruajtjen e cilësisë në organizimin e procesit mësimor ne raport me hapësirat që disponon si dhe rreth çështjes së angazhimit të stafit akademik ne universitetin publik dhe kolegjet private.

Heset Cakolli - lidhur me planin e fillimit me disa programeve të reja në disa qendra kërkoj sqarim nga rektori se a e lejon një gjë të tillë agjencia e Akreditimit.

Rektori Mujë Rugova - Agjencia e Akreditimit të Kosovës me rekomandimet e veta ka nxjerr ne pah se studentët do të kenë kuadër të nevojshëm arsimor, me përgatitje dhe eksperiencën e duhur, sa i përket angazhimit të mësimdhënësve rektori u shpreh se shumë shpejt ne Senat do të marrin një vendim përmes së cilit stafi akademik i UP-së do të përcaktohet për punë në institucione publike apo private. Po ashtu edhe sa i përket hapësirës nuk do të ketë problem pasi që tani është në përfundim objekti i Fakultetit të Edukimit dhe do të ketë hapësirë të mjaftueshme për degët e planifikuara.

Enis Kervan - kërkon që të vazhdohet me regjistrimin e studentëve ne programin e arsimit parafillor pasi që ka mungesë te këtij kuadri.

Donika Kadaj - Bujupi – theksoj se ne si komision mbështesim një plan të tillë të rektoratit për fillimin me këto programe edhe në qendra tjera pasi qe e gjithë kjo është në shërbim të ofrimit të kushteve me të mira për të rinjtë tanë. Po ashtu kërkoj nga rektorati qe të ofrojë ndihmë dhe bashkëpunim në drejtim të dërgimit të studentëve kosovar për studime ne Turqi pasi qe një gjë e tillë është mbështetur nga Këshilli i arsimit të lartë në Republikën e Turqisë.

Mbledhja përfundoj në orën 14:50.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Arsim Rexhepi
